Kronikë

Tiranë/ I gjejnë granata, municion luftarak e kallashnikov në banesë, në kërkim 50 vjeçari (VIDEO)

Granata, krehra pistolete dhe kallashnikovi, municion luftarak, i kishte fshehur në një enë prej bakri në banesë në fshatin Vilëz, Zall Bastar.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
9 Janar, 11:41 | **Përditesimi: 9 Janar, 12:00**

Share

Tirane- Granata, krehra pistolete dhe kallashnikovi, municion luftarak, i kishte fshehur në një enë prej bakri në banesë në fshatin Vilëz, Zall Bastar.

Policia e Tiranës ra në gjurmë pas informacioneve se në një banesë të këtij fshati kishte armë shpërthyese dhe sende të tjera të paligjshme.

Gjatë kontrollit në banesën e 50-vjeçarit, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar një pistoletë, katër granata, krehra pistolete, krehra kallashnikovi dhe municion luftarak, që dyshohet se i posedonte ky shtetas, informoi sot policia e Tiranës.

LEXO EDHE:
Keni një ide inovative për teknologjinë? Bashkia e Tiranës hap thirrjen për gjimnazistët

Policia po punon për arrestimin e Durim Vishës.

Kontrolli u bë nga policia e Komisariatit të Policisë Nr. 4, në kuadër të operacionit mbarëkombëtar "Sundimi i ligjit", për goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e mbajtjes pa leje të armëve dhe vënien përpara përgjegjësisë penale të shtetasve që i posedojnë ato.

S.G/Shqiptarja.com

TAG: zall bastar | fshati vilez | durim visha | Tirane

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si ju duket bashkimi i Ekonomisë, Kulturës e Inovacionit në një ministri?

I drejtë | I gabuar | Nuk e di

HOROSKOPI

Lajme të tjera

18-vjeçarja plagos ish të dashurin me thikë, zbuloi se e tradhtonte në kohën që ishin bashkë
9 Janar, 10:33

Tre aksidente me vdekje në Tiranë, në pranga tre të rinjtë! Edhe 38-vjeçari që përplasi 4-vjeçarin që humbi jetën
9 Janar, 10:20

Në kërkim për grup kriminal e trafik droge, në pranga nënë e bir në Tiranë! Do ekstradohen në Itali
9 Janar, 09:47

Rrezik për aksidente, gjobiten 296 drejtues monopatinash! Oficeri Baka: Ka shkelje flagrante të rregullave! Vëzhgimi i Report TV në Tiranë

Freard Rista
8 Janar, 17:00

Tiranë/ Sherr mes dy nxënësve në ambientet e gjimnazit 'Qemal Stafa', njëri plagoset me thikë në këmbë! Si nisi konflikti në klasë
8 Janar, 15:11

'Tempulli'/ Shiste kokainë e ekstazi, pranga 19-vjeçarit në Selitë të Tiranës
8 Janar, 12:01

Vodhën në një qendër tregtare në Tiranë, arrestohet 29-vjeçari, në hetim 3 të mitur
8 Janar, 09:29

Tiranë, 52 vjeçari gjendet i pajetë në një pallat të pabanuar, ja çfarë raportohet
7 Janar, 21:17

Zyrtare/ Dinamo largon tre futbollistë dhe gjen akordin me mbrojtësin e Kombëtares! Prezantohet Bamba
7 Janar, 16:20

Veliaj apel qytetarëve: Mos lini mobiliet e vjetra në mes të rrugës! Raportoni tek aplikacioni 'Tirana ime'
7 Janar, 13:57

U vidhnin para me dhunë qytetarëve në Tiranë, arrestohen 3 të rinjtë, mes tyre 2 të mitur! Njërit iu gjet kanabis në banesë
7 Janar, 09:15

Aksident në Tiranë, ndërron jetë 55 vjeçari, u përplas me makinë nga 21 vjeçari
6 Janar, 20:41

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje